



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 112 Prot

Tiranë, me 13.01.2014

Lënda: Dërgohet rekomandim për lehtësimin e procedurave për përfitim të statusit të invalidit dhe zgjerimin e listës së barnave të rimbursueshme.

Drejtuar: **Z. ILIR BEQAJ**
Ministër
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Z. ASTRIT BECI
Drejtor i Përgjithshëm
Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor

TIRANË

Të nderuar Zotërinj!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin si dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të nenit 32, pika 1, shkronja “f”, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Në kuadër të projektit me titull “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zvicëran në Tiranë, po zhvillohen Ditë të Hapura dhe takime me OJF-të në qytete të ndryshme të Shqipërisë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe zbatimin e tij të plotë nga gjithë aktorët e përcaktuar në ligj.

Gjatë zhvillimit të këtyre aktivitete, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi njihet drejtpërdrejtë me problematikat e komuniteteve në këto rajone.

Kështu, në qytetin e Lezhës janë evidentuar këto problematika:



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

- Ka pengesa dhe vështirësi gjatë zbatimit të procedurës për përfitimin e statusit të invalidit.
- Personat me Aftësi të Kufizuara kanë pamundësi në përballimin e shpenzimeve të barnave, të cilat nuk bëjnë pjesë në listën e barnave që rimbursohen. Për shkak të listës së kufizuar të barnave, grupet e personave me aftësi të kufizuar që gëzojnë statusin e invalidit, duhet të përballojnë shpenzimet për barnat me pagesën e aftësisë së kufizuar që ata marrin. Duhet patur parasysh se rimbursimi i barnave është një nevojë e domosdoshme për të gjitha kategoritë duke qenë se pagesat mujore për personat me aftësi të kufizuara krijojnë barriera, duke mos përballuar dot nevojat me imediate të jetesës se përditshme.

Lidhur me këto dy problematika, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij, që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe ka si qëllim të ofrojë barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, propozon që të shihet mundësia, për ndërmarrjen e masave me qëllim përmirësimin e jetesës për këtë kategori vulnerabel.

Sa më lart, në mbështetje të nenit 32, pika 1, germa f, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ku thuhet se “Komisioneri ka kompetencë (...) të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”, si dhe me qëllim përmirësimin e jetesës dhe garantimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi të Personave me Aftësi të Kufizuara:

REKOMANDOJME:

1. Të mbahet parasysh zbatimi me korrektësi i procedurave për përfitimin e statusit të invalidit.
2. Rishikimin e listës së barnave të rimbursueshme për vitin 2014, duke mbajtur parasysh zgjerimin e kësaj liste me barna të rinj, të cilët duhet të jenë realisht efektiv dhe në proporcion me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, sipas kategorive të përcaktuara në ligj.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,



Konceptoi: Blerina Pirani

Datë: 27.01.2014



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al